



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3735/16 prot.

Datë 05.02.2025

V E N D I M

Nr. 184/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.02.2025 u shqyrtua ankesa me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analyses & Testing” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-29950-11-19-2024 me objekt “Shërbim për monitorim mjedisi” me fond limit 11,894,396 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol SHA.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Environmental management consultants” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Autoriteti Kontraktor:

Albpetrol SHA,
me adresë: Selia, Rruga Fier – Patos, km 7.

Ankimues:	Operatori Ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK, me NUIS K92402036A, me adresë: Zona kadastrale 2679, hyrja 2, apartamenti 39, Tiranë.
Subjekte të Interesuar:	Operatori ekonomik “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analyses & Testing” SHPK, me NUIS K81317002P, me adresë Rruga Bedri Karapici, Kompleksi Tirana Golden Park, Hyrja e Biznesit, Kati i parë, Nr. 5, Tirane
Baza Ligjore:	Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.11.2024, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-29950-11-19-2024 me objekt “Shërbim për monitorim mjedisi” me fond limit 11,894,396 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol SHA.

II.2. Në datën 12.12.2024, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, janë njoftuar elektronikisht për vlerësimin e ofertave si më poshtë vijon:

“ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analyses & Testing” SHPK	8.189.469,74 lekë, kualifikuar
“Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK	8.920.900,00 lekë, kualifikuar
“Environmental management consultants” SHPK	9.155.432,00 lekë, kualifikuar

II.3. Në datën 17.12.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit të procedurës së mësipërme të prokurimit në SPE.

II.4. Në datën 23.12.2024 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4922 dhe nr. 3735/2024 protokolli, datë 24.12.2024 e operatorit ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-29950-11-19-2024 me objekt “*Shërbim për monitorim mjedisi*” me fond limit 11,894,396 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol SHA.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analyses & Testing” SHPK dhe kualifikimin e ofertës të paraqitur operatori ekonomik “Environmental management consultants” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Konkretisht pretendohet si vijon:

“Kerkesa nr.1

Ne lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik ECCAT Environmental consulting, chemical analyses & testing, ky operator nuk ploteson kerkesat e pikes 2.3.8 te shtojces nr.9 (FORMULAR I I KRITEREVE TE PERZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT) ne te cilen citohet:

2.3.8 Operatori ekonomik duhet te disponoje:

- *Laborator te akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit sipas ISO 17025:2017, te pakten 1(nje), per monitorimin e cilesise se ajrit, ujit dhe monitorimin e zhurmave, sipas termave te references, i cili te jete ne pronesi ose me qira.*

Për këtë të paraqiten:

- Certifikata e akreditimit te laboratorit leshuar ne emer te operatorit ekonomik.
- Nese laboratori eshte me qira ose me kontrate bashkepunimi te paraqitet kontrata e qirase ose e bashkepunimit, me afat jo më te shkurter se periudha qe do te ofrohet sherbimi se bashku me certifikaten e akreditimit.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet te paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.10. Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzoje pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Duke verifikuar ne faqen zyrtare te Drejtorise se Pergjithshme te Akreditimit, konkretisht certifikaten e operatorit ekonomik ECCAT Environmental consulting, chemical analyses & testing (<https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>) konstatohet se ky operator nuk i ploteson te gjitha parametrat e kerkuara ne shtojcen nr.8 Formulari i termave te references. Konkretisht ne certifikaten e akreditimit te operatorit ekonomik ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analyses & Testing mungojne parametrat ujit si me poshte:

? temperature

? toksiciteti

? rrjedha,

? rrjedha ditore,

? rrjedha maksimale,

? grimcat,

? PM10.

Ne keto kushte mendojme qe operatori ekonomik ECCAT Environmental consulting, chemical analyses & testing nuk duhet te kualifikohet pasi nuk ploteson kriterin ne piken 2.3.8 te shtojces nr.9 te DST-ve.

Kerkesa nr.2

Se pari, ne lidhje me kualifikimin e ofertes te operatorit ekonomik Environmental management consultants, shoqeria jone, legjitimohet per ankimim te ketij operatori ekonomik pavaresisht ofertes se tyre me te larte se oferta jone, pasi mos kualifikimi i operatorit ekonomik Environmental management consultants, nxjerr anomalisht te ulet oferten e operatorit ekonomik ECCAT Environmental consulting, chemical analyses & testing. Ne keto kushte, per proceduren e hapur, ne proceduren e prokurimit me vlere nen kufijte e larte monetar, KVO duhet ta skualifikoj nga procedura pa i kerkuar sqarim, nese oferta rezulton anomalisht e ulet, si me poshte:

? Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

? Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Nga vleresimi i ofertave ekonomike rezultoj renditja:

Operatoret ekonomik	Vlerat e ofertuara	Refuzuar
ECCAT Environmental consulting, chemical analyses & testing	8189469,74	JO
Qendra e monitorimit te Mjedisit shpk	8920900,00	JO
Environmental management consultants	9155432,00	JO

Sipas renditjes se ofertave, oferta e operatorit ekonomik ECCAT Environmental consulting, chemical analyses & testing eshte me e ulet se 25% e fondit limit, gje e cila e con ne skualifikim te kesaj oferte, dhe shpallje fituese oferten e paraqitur nga ana jone, nese nuk kualifikohet oferta e operatorit ekonomik Environmental management consultants.

Per sa me siper pasqyrohet interesi dhe legjitimimi jone per ankimimin e kualifikimit te operatorit ekonomik Environmental management consultants.

Se dyti, kualifikimi i operatorit ekonomik Environmental management consultants eshte ne kundërshtim me kërkesen ne piken 2.3.8 te shtojces nr.9 te DST-ve, ne te cilen citohet si me poshte:

2.3.8 Operatori ekonomik duhet te disponoje:

- Laborator te akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit sipas ISO 17025:2017, te pakten 1(nje), per monitorimin e cilesise se ajrit, ujit dhe monitorimin e zhurmave, sipas termave te references, i cili te jete ne pronesi ose me qira.

Për këtë të paraqiten:

- Certifikata e akreditimit te laboratorit leshuar ne emer te operatorit ekonomik.
- Nese laboratori eshte me qira ose me kontrate bashkepunimi te paraqitet kontrata e qirase ose e bashkepunimit, me afat jo më te shkurter se periudha qe do te ofrohet sherbimi se bashku me certifikaten e akreditimit.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet te paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.10. Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzoje pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Ne faqen zyrtare te te Drejtorise se Pergjithshme te Akreditimit, (<https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>) operatori ekonomik Environmental management consultants nuk figuron ne listen e laboreve mjedisore te akredituar. Labororet mjedisore te akredituar sipas informacionit ne faqen zyrtare te te Drejtorise se Pergjithshme te Akreditimit, (<https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>) jane:

1. ECCAT Environmental consulting, chemical analyses & testing (Certifikate akreditimi nr.LT 128)
2. Eko-studio Projekt shpk (Certifikate akreditimi nr.LT 070)
3. GR Albania shpk (Certifikate akreditimi nr.LT 083)
4. Tenuis Laboratories (Certifikate akreditimi nr.LT 122)
5. Go Green (Certifikate akreditimi nr.LT 085)
6. Instituti i studimeve ambientale (Certifikate akreditimi nr.LT 088)
7. ECM Studio shpk (Certifikate akreditimi nr.LT 095)
8. Qendra e Monitorimit te Mjedisit shpk (QMM) (Certifikate akreditimi nr.LT 096)
9. Alpha studio shpk (Certifikate akreditimi nr.LT 098)
10. S.W.O.T Shpk (Certifikate akreditimi nr.LT 130)
11. Leni-ING shpk (Certifikate akreditimi nr.LT 104)

12. AQSCERT shpk (Certifikate akreditimi nr.LT 121)
13. Laboratori A Consultant (Certifikate akreditimi nr.LT 123)
14. Studio Eko-keshillim shpk (Certifikate akreditimi nr.LT 124)
15. VIELF Studio shpk (Certifikate akreditimi nr.LT 127)

Operatoret ekonomik, ECCAT Environmental consulting, chemical analyses & testing dhe Qendra e Monitorimit të Mjedisit shpk janë pjesë e kësaj procedure prokurimi. Te gjithë laboratoret e tjere mjedisore, me të cilët operatori ekonomik Environmental management consultants mund të ketë marrëveshje bashkepunimi ose kontratë qeraje për laboratorin, nuk i plotësojnë parametrat e akredituar të kerkuar për testim (të përcaktuar në shtojcën nr.8 Formulari i termave të referencës) sipas kërkesës të pikës 2.3.8 të shtojcës nr.9 të DST-ve, “Laborator të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit sipas ISO 17025:2017, të pakten 1(nje), për monitorimin e cilesise se ajrit, ujit dhe monitorimin e zhurmave, sipas termave të referencës, i cili të jetë në pronesi ose me qira.”.

Operatori ekonomik Environmental management consultants nuk plotëson me parametra të akredituar sipas termave të referencës (shtojca nr.8) të kerkuar në pikën 2.3.8 të shtojcës nr.9 të DST-ve. Për kualifikimin e këtij operatori ekonomik nga ana e KVO në këtë procedure prokurimi është në kundërshtim me LPP..”

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr.3735/2, datë 24.12.2024, me kriteret që operatori ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga shoqëria “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analyses & Testing” SHPK, të parashtruara në ankesën me nr.3735 prot., datë 24.12.2024.

II.6. Në datën 31.12.2024, në Komisionin e Prokurimit Publik është protokolluar me nr. 3735/3, Vendimi i KSHA-së “Për shqyrtim ankese” me nr. 7328/2 prot., datë 30.12.2024, ardhur nëpërmjet postës elektronike të KPP-së. Gjithashtu në datën 06.01.2024, në Komisionin e Prokurimit Publik është protokolluar me nr. 3735/4, shkresa e autoritetit kontraktor nr. 3728/3 prot., datë 31.12.2024 me objekt: “Dërgim vendimi mbi ankesën e operatorit ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK për procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbim për monitorim mjedisi me REF-29950-11-19-2024””, bashkëngjitur përsëri Vendimi i KSHA-së “Për shqyrtim ankese” me nr. 7328/2 prot., datë 30.12.2024. Referuar Vendimit të KSHA-së rezulton, se autoriteti kontraktor e ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK, duke argumentuar si vijon:

“[...] Ankimesi arsyeton si më poshtë:

Kërkesa nr.1

Në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik ECCAT Environmental consulting, chemical analyses & testing, ky operator nuk plotëson kërkesat e pikës 2.3.8 të shtojcës nr.9 (FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT) në të cilën citohet:

2.3.8 Operatori ekonomik duhet te disponoje: • Laborator te akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit sipas ISO 17025:2017, te pakten 1(nje), per monitorimin e cilesise se ajrit, ujit dhe monitorimin e zhurmave, sipas termave te references, i cili te jete ne pronesi ose me qira. Për këtë të paraqiten: - Certifikata e akreditimit te laboratorit leshuar ne emer te operatorit ekonomik.

Nese laboratori eshte me qira ose me kontrate bashkepunimi te paraqitet kontrata e qirase ose e bashkepunimit, me afat jo më te shkurter se periudha qe do te ofrohet sherbimi se bashku me certifikaten e akreditimit. Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet te paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.10. Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzoje pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Duke verifikuar ne faqen zyrtare te Drejtorise se Pergjithshme te Akreditimit, konkretisht certifikaten e operatorit ekonomik ECCAT Environmental consulting, chemical analyses & testing (<https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>) konstatohet se ky operator nuk i ploteson te gjitha parametrat e kerkuara ne shtojcen nr.8 Formulari I termave te references. Konkretisht ne certifikaten e akreditimit te operatorit ekonomik ECCAT Environmental consulting, chemical analyses & testing mungojne parametrat ujit si me poshte:

- ☐ temperature
- ☐ toksiciteti
- ☐ rrjedha,
- ☐ rrjedha ditore
- ☐ rrjedha maksimale
- ☐ grimcat
- ☐ PM10.

Ne keto kushte mendojme qe operatori ekonomik ECCAT Environmental consulting, chemical analyses & testing nuk duhet te kualifikohet pasi nuk ploteson kriterin ne piken 2.3.8 te shtojces nr.9 te DST-ve.

ARSYETIMI I KSHA:

KSHA nga shqyrtimi i dosjes së tenderit, komunikimi me KVO dhe keqyrja e dokumentacionit të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi në SPE, konstaton se:

Për sa i përket pretendimit Tuaj mbi mospërmbushjen e kriterit 2.3.8 të DST-së, nga ana e OE pjesmarrës “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analyses & Testing” SHPK, Ju sqarojmë se OE në shtojcën 10 Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit deklaroi se “disponon Laborator i Akredituar ne pronesi per te gjitha parametrat e kerkuar ne termat e references. Certifikata bashkangjitur”. Ky kriter nga ana e KVO kondiderohet i plotësuar dhe duhet të konsiderohet si i tillë pasi kërkesa e AK në DST është konkretisht: “Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet te paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.10. Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzoje pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër”. Pra detyrimi i OE për këtë fazë përzgjedhjeje ka qënë deklarimi nëpërmjet shtojcës 10.

Nisur nga fakti që për shkak të ofertës më të ulët në këtë konkurim ky OE është shpallur fitues, ai ka paraqitur dokumentacionin justifikues pranë AK.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE si rezultat i shpalljes së tij fitues, në dosjen e tenderit, konstatohet se OE ka paraqitur dokumentacionin plotësues për kriterin 2.3.8. pra dokumentacionin me të cilin vërteton disponimin e laboratorit të akredituar sipas kërkesave të AK në specifikimet teknike. OE ka paraqitur pranë AK dokumentacionin (certifikatë akreditimi) për Laboratorin në pronësi të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit sipas ISO 17025:2017, për monitorimin e cilesise se ajrit, ujit dhe monitorimin e zhurmave, sipas termave të referencës, akredituar më 11.03.2024 të vlefshme deri më datë 10.03.2028.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit për këtë pikë nuk qëndron.

2. Ankimuesi arsyeton si më poshtë:

Se pari, në lidhje me kualifikimin e ofertes të operatorit ekonomik Environmental management consultants, shoqëria jone, legjitimohet për ankimim të këtij operatori ekonomik pavarësisht ofertes se tyre me të lartë se oferta jone, pasi mos kualifikimi i operatorit ekonomik Environmental management consultants, nxjerr anomalisht të ulët ofertën e operatorit ekonomik ECCAT Environmental consulting, chemical analyses & testing. Në këtë kusht, për procedurën e hapur, në procedurën e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetar, KVO duhet të skualifikoj nga procedura pa i kërkuar sqarim, nëse oferta rezulton anomalisht e ulët, si më poshtë:

☐ Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

☐ Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Nga vlerësimi i ofertave ekonomike rezultojnë renditja:

Operatorët ekonomik Vlerat e ofertuara Refuzuar

ECCAT Environmental consulting, chemical analyses & testing 8189469,74 JO

Qendra e monitorimit të Mjedisit shpk 8920900,00 JO

Environmental management consultants 9155432,00 JO

Sipas renditjes së ofertave, oferta e operatorit ekonomik ECCAT Environmental consulting, chemical analyses & testing është me e ulët se 25% e fondit limit, gjë e cila e konfirmon skualifikimin të kësaj oferte, dhe shpallje fituese ofertën e paraqitur nga ana jone, nëse nuk kualifikohet oferta e operatorit ekonomik Environmental management consultants.

Për sa më sipër pasqyrohet interesi dhe legjitimiteti jone për ankimimin e kualifikimit të operatorit ekonomik Environmental management consultants.

Se dyti, kualifikimi i operatorit ekonomik Environmental management consultants është në kundërshtim me kërkesën në pikën 2.3.8 të shtojcës nr.9 të DST-ve, në të cilën citohet si më poshtë:

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë:

-Laborator te akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit sipas ISO 17025:2017, te pakten 1(nje), per monitorimin e cilesise se ajrit, ujit dhe monitorimin e zhurmave, sipas termave te references, i cili te jete ne pronesi ose me qira.

Për këtë të paraqiten:

- Certifikata e akreditimit te laboratorit leshuar ne emer te operatorit ekonomik.*
- Nese laboratori eshte me qira ose me kontrate bashkepunimi te paraqitet kontrata e qirase ose e bashkepunimit, me afat jo më te shkurter se periudha qe do te ofrohet sherbimi se bashku me certifikaten e akreditimit.*

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet te paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.10. Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzoje pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Ne faqen zyrtare te te Drejtorise se Pergjithshme te Akreditimit, (<https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>) operatori ekonomik Environmental management consultants nuk figuron ne listen e laboreve mjedisore te akredituar. Labororet mjedisore te akredituar sipas informacionit ne faqen zyrtare te Drejtorise se Pergjithshme te Akreditimit, (<https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>) jane:

- 1.ECCAT Environmental consulting, chemical analyses & testing (Certifikate akreditimi nr.LT 128)*
- 2. Eko-studio Projekt shpk (Certifikate akreditimi nr.LT 070)*
- 3. GR Albania shpk (Certifikate akreditimi nr.LT 083)*
- 4. Tenuis Laboratories (Certifikate akreditimi nr.LT 122)*
- 5. Go Green (Certifikate akreditimi nr.LT 085)*
- 6. Instituti i studimeve ambientale (Certifikate akreditimi nr.LT 088)*
- 7. ECM Studio shpk (Certifikate akreditimi nr.LT 095)*
- 8. Qendra e Monitorimit te Mjedisit shpk (QMM) (Certifikate akreditimi nr.LT 096)*
- 9. Alpha studio shpk (Certifikate akreditimi nr.LT 098)*
- 10. S.W.O.T Shpk (Certifikate akreditimi nr.LT 130)*
- 11. Leni-ING shpk (Certifikate akreditimi nr.LT 104)*
- 12. AQSCERT shpk (Certifikate akreditimi nr.LT 121)*
- 13. Laboratori A Consultant (Certifikate akreditimi nr.LT 123)*
- 14. Studio Eko-keshillim shpk (Certifikate akreditimi nr.LT 124)*
- 15. VIELF Studio shpk (Certifikate akreditimi nr.LT 127)*

Operatorët ekonomik, ECCAT Environmental consulting, chemical analyses & testing dhe Qendra e Monitorimit te Mjedisit shpk jane pjese e kesaj procedure prokurimi. Te gjithë labororet e tjere mjedisore, me te cilet operatori ekonomik Environmental management consultants mund te kete marreveshje bashkepunimi ose kontrate qeraje per laboratorin, nuk i plotesojne parametrat e akredituar te kerkuar per testim (te percaktuar ne shtojcen nr.8 Formulari i termave te references) sipas kerkeses te pikes 2.3.8 te shtojces nr.9 te DST-ve, Laborator te akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit sipas ISO 17025:2017, te pakten 1(nje), per monitorimin e cilesise se ajrit, ujit dhe monitorimin e zhurmave, sipas termave te references, i cili te jete ne pronesi ose me qira.”.

Operatori ekonomik Environmental management consultants nuk ploteson me parametra te akredituar sipas termave te references (shtojca nr.8) te kerkuar ne piken 2.3.8 te shtojces nr.9 te DST-ve. Pra kualifikimi i ketij operatori ekonomik nga ana e KVO ne kete procedure prokurimi eshte ne kundërshtim me LPP.

Per arsyet e paraqitura me siper mendojme se operatori ekonomik nuk duhet te kualifikohet

ARSYETIMI I KSHA:

Së pari, përsa i përket pretendimit Tuaj për skualifikimin e OE "Environmental management consultants" gjykojmë se:

Ky OE është paraqitur si BOE në këtë procedurë prokurimi me OE "ALPHA STUDIO" sh.p.k. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE rezulton se OE "Environmental management consultants" dhe OE "ALPHA STUDIO" sh.p.k. kanë një marrëveshje bashkëpunimi midis tyre duke ndarë në % shërbimet që do të ofrojnë. Dhe ju vetë në listën e laboratorëve të akredituar keni përmendur si shoqëri të akredituar shoqërinë "Alpha studio" shpk (Certifikate akreditimi nr.LT 098). OE "ALPHA STUDIO" sh.p.k. ka deklaruar nëpërmjet shtojcës 10 se e përmbush plotësisht kriterin e pikës 2.3.8 te shtojces nr.9 te DSTve, shprehimisht citon se disponon:

"Laborator ne pronesi te "ALPHA STUDIO" SHPK, me Certificate Akreditimi me nr. Regjistrimi LT 098 date 22.11.2023, me afat deri me 21.11.2027, leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit, pjese e anetare (MLA signatory bodies) me te drejta te plote per ISO 17025 prane Drejtorise Evropiane te Akreditimit"

KSHA gjykon se kriteri i kërkuar nga AK është i përmbushur në këtë fazë vlerësimi nga BOE dhe vlerësimi i KVO është korrekt.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit për këtë pikë nuk qëndron.

Bazuar në nenin 114 të ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 102 të vendimit nr. 285, të Këshillit të Ministrave, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", KSHA. VENDOSI: 1. Të refuzojë ankesën e paraqitur nga OE "QËNDRA E MONITORIMIT TË MJEDISIT" shpk."

II.7. Në datën 16.01.2025 Komisioni i Prokurimit Publik ripublikoi formularin e publikimit me kriteret që operatori ekonomik "Qendra e Monitorimit të Mjedisit" SHPK pretendon se nuk përmbushen nga shoqëria "ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analyses & Testing" SHPK, dhe shoqëria "Environmental management consultants" SHPK të parashtruara në ankesën me nr.3735 prot., datë 24.12.2024. Gjithashtu pretendohet se oferta e shoqërisë "ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analyses & Testing" SHPK, do të rezultonte anomalisht e ulët, nëse do të skualifikohej shoqëria "Environmental management consultants" SHPK.

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 3735/12 prot., datë 17.01.2025 Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit shprehimisht si vijon: "Në kuadër të shqyrtimit të ankesës së paraqitur për një procedurë prokurimi, Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e kryerjes së procedurës së hetimit administrativ, lidhur me pretendimet e ngritura. Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës konstatohen pretendime lidhur me përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor përsa i përket specifikimeve teknike

dhe konkretisht pretendohet se: “ne certifikaten e akreditimit te operatorit ekonomik ECCAT Environmental consulting, chemical analyses & testing mungojne parametrat ujit si me poshte:

? temperature

? toksiciteti

? rrjedha,

? rrjedha ditore,

? rrjedha maksimale,

? grimcat,

? PM10.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 115, pika 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” si dhe ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, KPP ju drejtohet juve, si institucion kompetent, për një sqarim nëse Certifikata e Akreditimit, me Nr. Regjistrimi LT 128, “Laborator Testues” lëshuar nga ana juaj për shoqërinë “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analyses & Testing” SHPK, lejon apo jo kryerjen e testimeve për parametart e ujit si më sipër cituar.”

II.9. Në datën 03.02.2025 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 3735/13 prot., shkresa e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit nr. 75/1 prot., datë 22.01.2025 me objekt: “Kthim përgjigje”, me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“Në përgjigje të shkresës tuaj nr.3735/12 prot., datë 17.01.2025 “Kërkesë për informacion”, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) ju bën me dije se në faqen zyrtare të DPA, <https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara>, janë pasqyruar të gjithë laboratorët e akredituar si dhe fusha përkatëse e akreditimit ku mund të merrni informacion të detajuar për analizat e kërkuara. Gjithashtu DPA sqaron se:

- PM10: është një parametër i cilësisë së ajrit. (Nuk matet PM10 në ujë).
- Grimcat: përfaqësojnë substanca të pezulluara në ujë (p,sg sedimentet). Në ujë matet lënda pezull dhe TSS. (Testi nr.21 në listën e testeve të akredituara të laboratorit ECCAT- Enviromental Consulting, Chemical Analyses&Testing” SHPK).
- Laboratori ECCAT nuk është i akredituar për parametrat e ujit si: Temperatura, rrjedha, rrjedha ditore dhe rrjedha maksimale.
- Laboratori ECCAT nuk është i akredituar për matjen direkt të parametrat të toksicitetit në ujë, por është i akredituar për matjen e Hidrokarbureve Policiklike Aromatike (PAH) , alifatike, bifenilet e polikloruara (PCB) si dhe për matjen e metaleve të rënda. (Testet nr. 58, 59, 60, 62, 71, 72, 75, 77, 79, 118 në listën e testeve të akredituara të laboratorit ECCAT- Enviromental Consulting, Chemical Analyses&Testing” SHPK).

II.10. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur të saj si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga ana e autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “*Ne lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik ECCAT Environmental consulting, chemical analyses & testing, ky operator nuk ploteson kërkesat e pikes 2.3.8 te shtojces nr.9 (FORMULAR I I KRITEREVE TE PERZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT) ne te cilen citohet:*

2.3.8 Operatori ekonomik duhet te disponoje:

- *Laborator te akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit sipas ISO 17025:2017, te pakten 1(nje), per monitorimin e cilesise se ajrit, ujit dhe monitorimin e zhurmave, sipas termave te references, i cili te jete ne pronesi ose me qira.*

Për këtë të paraqiten:

- *Certifikata e akreditimit te laboratorit leshuar ne emer te operatorit ekonomik.*
- *Nese laboratori eshte me qira ose me kontrate bashkepunimi te paraqitet kontrata e qirase ose e bashkepunimit, me afat jo më te shkurter se periudha qe do te ofrohet sherbimi se bashku me certifikaten e akreditimit.*

Shenim: *Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet te paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.10. Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzoje pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

Duke verifikuar ne faqen zyrtare te Drejtorise se Pergjithshme te Akreditimit, konkretisht certifikaten e operatorit ekonomik ECCAT Environmental consulting, chemical analyses & testing (<https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>) konstatohet se ky operator nuk i ploteson te gjitha parametrat e kerkuara ne shtojcen nr.8 Formulari i termave te references. Konkretisht ne certifikaten e akreditimit te operatorit ekonomik ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analyses & Testing mungojne parametrat ujit si me poshte:

? temperature

? toksiciteti

? rrjedha,

? rrjedha ditore,

? rrjedha maksimale,

? grimcat,

? PM10.

Ne keto kushte mendojme qe operatori ekonomik ECCAT Environmental consulting, chemical analyses & testing nuk duhet te kualifikohet pasi nuk ploteson kriterin ne piken 2.3.8 te shtojces nr.9 te DST-ve”,

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.8, të dokumenteve të tenderit të publikuara në SPE, rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar si më poshtë vijon:

2.3.8.Operatori ekonomik duhet te disponoje:

- Laborator te akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit sipas ISO 17025:2017, te pakten 1(nje), per monitorimin e cilesise se ajrit, ujit dhe monitorimin e zhurmave, sipas termave te references, i cili te jete ne pronesi ose me qira.

Për këtë të paraqiten:

- Certifikata e akreditimit te laboratorit leshuar ne emer te operatorit ekonomik.
- Nese laborator eshte me qira ose me kontrate bashkepunimi te paraqitet kontrata e qirase ose e bashkepunimit, me afat jo më te shkurter se periudha qe do te ofrohet sherbimi se bashku me certifikaten e akreditimit.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet te paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.10. Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzoje pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

III.1.2. Në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, të dokumentave të tenderit, është parashikuar si vijon:

Shtojca 6.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Bazuar në ligjin Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, Neni 41 “Monitorimi i Gjëndjes së Mjedisit”, Neni 44 “Detyrimet e operatorit për monitorimin e përputhshmërisë”, Ligjin 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” i ndryshuar, si dhe në zbatim të kushteve të Lejeve Mjedisore (A dhe B sipas rastit), monitorimi mjedisor është detyrim ligjor dhe duhet të kryhet nga studio ligjore me ekspertë të licensuar dhe me pervojë në fushën e monitorimeve, gjithashtu të kenë paisjet, laboratorët dhe aparatet përkatëse, të certifikuar dhe akredituar. Operatori do të kryejë monitorimin mjedisor sipas specifikimeve teknike, pikave të monitorimit dhe termave të referencës si më poshtë bashkëlidhur.

Periudha e monitorimit do të jetë 12 mujore nga data e nënshkrimit të kontratës.

Referuar ligjit Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, Neni 44 “Detyrimet e operatorit për monitorimin e përputhshmërisë” Pika 3 e këtij neni shprehet: “Operatori mund

të kryejë monitorimin nëpërmjet pajisjeve dhe instrumenteve të akredituara që ai disponon ose nëpërmjet laboratorëve të specializuar e të akredituar”, operatori ekonomikë duhet të ketë në pronësi ose me qera, laborator të akredituar për kryerjen e këtyre analizave, (për testimin e gazeve në ajër, zhurmave dhe ujrave të shkarkimit sipas elementëve të kërkuar në secilen prej Leje Mjedisore). Të disponojë Çertifikatë Akreditimi aktive për të gjithë periudhën e shërbimit të kërkuar dhe të ketë ekspertë të licensuar dhe me pervojë në fushën e monitorimeve mjedisore.

Pas nënshkrimit të kontratës, operatori fitues duhet të plotësojë dhe të dorëzojë pranë shoqërisë “Albpetrol” sh.a katër kopje për çdo raport monitorimi mjedisor, si dhe një kopje të dorëzohet pranë AKM Tiranë, në përputhje me kërkesat dhe kushtet e lejeve mjedisore si më poshtë:

Për Lejet Mjedisore të tipit A

- | | |
|---|---------------|
| 1- Monitorimi i shkarkimeve në atmosferë | çdo 3-muaj |
| 2- Monitorimi i shkarkimeve në ujra | çdo 3-muaj |
| 3- Monitorimi i ujrave sipërfaqësorë | çdo 3-muaj |
| 4- Monitorimi i zhurmave dhe vibracioneve | çdo 3-muaj |
| 5- Raporti Vjetor i Mjedisit | 1 herë në vit |

Për Lejet Mjedisore të Tipit B

- | | |
|---|---------------|
| 1- Monitorimi i shkarkimeve në atmosferë | çdo 6-muaj |
| 2- Monitorimi i shkarkimeve në ujra | çdo 6-muaj |
| 3- Monitorimi i ujrave sipërfaqësorë | çdo 6-muaj |
| 4- Monitorimi i zhurmave dhe vibracioneve | çdo 6-muaj |
| 5- Raporti Vjetor i Mjedisit | 1 herë në vit |

Në bazë të programit të monitorimit, sipas pikave të përcaktuara kërkohet:

Monitorimi i shkarkimeve në ajër, në kanalizime, shkarkimet në ujrë sipërfaqësorë dhe monitorimi i zhurmave dhe vibracionet, do të kryhet për të gjithë komponentët referuar Kushtit 7 “Shkarkimet”, Kushtit 9 “Zhurmat dhe Vibracionet” dhe Kushtit 11 “Monitorimi” të secilës Leje Mjedisore.

1 - Monitorimi i cilësisë së ajrit

Grimcat, PM10,

Gazet në mjedis SO₂, O₂, NO_x, TOC, H₂S, CO.

2 - Monitorimi i cilësisë së ujrave në kanalizime dhe ujra sipërfaqësorë.

Grimcat, PM10, Rrjedhja, pH, temperaturë, toksiteti, TSS, NBO-5, NKO, COD, BOD5 Produkte naftë, Fenole volatile, Sulfide, Klorure, Metale toksik (në total), Azot Amonjak N mg/l, Azot total, Fosfor total, Cd, Cr, Cr (VI), As, Pb, Hg, Zn, Fe, Ni, Cianid i lirë, Cianid Total.

3 - Monitorimi i ndotjes akustike

Zhurma në mjedis dhe në vendin e punës sipas kushteve të përcaktuara në Lejet Mjedisore.

4 – Vibrimet (matja e vibrimeve si pasojë e aktivitetit të operimit)

Matja e vibrimeve do të kryhet për vende të ndjeshme në mm/s (ppv).

Të gjitha monitorimet duhet të kryhen për secilën pikë, në përputhje me Kushtet e Lejeve Mjedisore. Marrja e mostrave dhe analizat duhet të kryhen siç përcaktohen në standartet ISO.

Operatori duhet të disponojë certifikatat e kalibrimit që provon se instrumentat që do të përdoren për matjen/testimin e parametrave të lart përmendur përmbushin kushtet teknike dhe janë të kolauduar.

Programi i monitorimit të 7 Lejeve Mjedisore të Albpetrol sh.a. me 80 pika monitorimi është si më poshtë:

1. Q.A.SH.N.G.Patos (12 Pika për Monitorim, Leje Tipi B).

1-Leja Mjedisore (L.M.) PN-6483-05-2018 dhe me nr identifikues të Lejes 2785 (pikat 11-12) dhe 2-LC 4234–PN 3540, dt.21/05/2012 me nr identifikues të Lejes 651 “Shpërndarje dhe magazinim i naftës dhe nënprodukteve në çisterna” (pikat 1-10)

Shënim: 2-LC 4234–PN 3540, dt.21/05/2012 “Shpërndarje dhe magazinim i naftës dhe nënprodukteve në çisterna” për shkak të ndryshimeve ligjore do të rinxirren më vete për çdo stacion. Në momentin e pajisjes me Lejet e reja operatori do kryej monitorimin sipas kushteve të Lejeve të reja.

▪ <u>Stacioni Usoje:</u> 1 - Salla e pompave, 2 - Parku i rezervuarve, 3 - Ne tunele	▪ <u>Stacioni Marinëz-Sheqishte:</u> 6- Parku i rezervuarve Marinez
	▪ <u>Stacioni Zharrez:</u> 7 - Salla e pompave, 8 - Parku i rezervuarve 5000 m³, 9 - Parku i rezervuarve 700 m³, 10 - Kaldaja.
▪ <u>Stacioni Visoke:</u> ▪ 4 - Salla e pompave, 5 - Parku i rezervuarve,	▪ <u>Stacioni Kuçove:</u> 11 - Salla e pompave, 12 - Parku i rezervuarve

Në këto pika do të kryhet:

Monitorimi i shkarkimit në ajër:

Grimcat,
PM 10,
VOC, H₂S.

Shkarkimet në kanalizime:

Rrjedhja ditore m^3 , Rrjedhja m^3/h , Rrjedhja max m^3/h , pH, temperatura, toksiciteti, NBO-5 ne 20° pa nitrifikim, NKO, O i shpërbërë, Azot Amonjak N mg/l, përbërës organik të fosforit.

Shkarkimet në ujrat sipërfaqësorë:

Rrjedhja m^3/h , pH, temperatura, toksiciteti, lëndë pezull (TSS), BOD5, produktet e naftës, fenole volative, sulfidet, metalet toksike (në total).

Zhurmat:

Matja e nivelit të zhurmës dB (A) Leq, T.

Vibrimet:

Matja e vibrimeve mm/s (PPV).

2. Q.P.N.Fier (23 Pika Monitorimi, Leje Tipi A) përfshihen 2 vëndburime Patos-Marinez dhe Cakran- Mollaj si më poshtë:

- **L.M. me nr. PN-6621-06-2018 dhe me nr identifikues të Lejes 2807 “Nxjerrja e naftës dhe gazit natyror” për Vëndburimi e naftës dhe gazit Patos-Marinëz, Fier (15 pika monitorimi nga 13-27).**

▪ <u>Visokë (Oficina)</u> 13 - Dekantimi Visokë,	21 - St. 8 Patos,
▪ <u>Zharrëz, Sektori 6:</u> 14 - Gr 490 Zharrëz , 15 – Gr – 205, 16 - Gr – 11, 17 – Gr - 9 Kuqar, 18 - Stacioni 6, 19 - Stacioni 4, 20 - Depot pritëse të sektorit 6,	▪ <u>Sektori 5:</u> 22 - Depot pritëse të Sektorit të 5 Oficinë, 23 - Gr-7 Dukas, 24 – Gr – 3 Manekaj, 25 – Gr – 9 Rërëz, 26 - G- 5 – Dukas, 27 - Stacioni 2.

Monitorimi i shkarkimit në ajër:

PM 10,

VOC,

SO₂, NO_x, NO₂, TOC, H₂S, CO.

Shkarkimet në kanalizime:

Rrjedhja ditore m^3 , Rrjedhja m^3/h , rrjedhja max $m^3/orë$, pH, temperatura, toksiciteti, O i shpërbërë, Azot Amonjaku si N mg/l, përbërës organik të fosforit.

Shkarkimet në ujrat sipërfaqësorë:

Rrjedhja ditore m^3 , Rrjedhja ditore m^3/h , rrjedhja max $m^3/orë$, grimcat, PM10, pH, temperatura, toksiciteti, O i shpërbërë, Azot Amonjaku si N mg/l, përbërës organik të fosforit, lëndë pezull, BOD5, produkte naftë, fenole volative, Sulfide, Metale Toksikë (në total).

Zhurmat:

Matja e nivelit të zhurmës dB (A) (Leq, t).

- **Vendburimi i naftës Cakran - Mollaj L.M. me nr. PN-6161-09-2013**
“Zhvillimi dhe prodhimi i hidrokarbureve” për vendburimin e naftës Cakran-Mollaj (8 pika monitorimi nga 28-35).

<u>Spektori Cakran-Mollaj</u>	30 - Q 25	33 - Q 29
28 - Dekantimi Usojë	31 - Q 59	34 - Q 38
29 - Grupi 3 Mollaj	32 - Q 17	35 - Q 35

Monitorimi i shkarkimit në ajër:

Substancat e ngurta (LN), SO₂, NO₂, H₂S.

Ujrat teknologjike:

pH, lëndë pezull, BOD₅, COD, Nitrat total, Produkte naftë, Cadium, Bakri. Krom 6 valent, Fenole volatile, Benzene, Vinilkloridet, Sulfitet.

Zhurmat:

Niveli i zhurmave dB (A) Leq, T.

3. Q.P.N.Kuçovë (27 Pika Monitorimi, Leje Tipi A)

- **L.M. PN-6622-06-2018 dhe me nr. identifikues të Lejes 2806** “Nxjerrje e naftës dhe gazit natyror” në vendburimi e naftës Kuçovë (27 Pika Monitorimi nga nr 36-62).

▪ <u>Spektori 6 :</u> 36 - Dekantimi dhe Stacioni Qendror, 37 - Stacioni i Lumit.		▪ <u>Spektori 2:</u> 38 - Grupi St-5 39 - Grupi Q- 163 40 - Grupi 522 41 - Grupi Q 200 42 - Grupi St 82	▪ <u>Spektori 1</u> 43 - Grupi Ç - 1 44 - Grupi 223 45 - Grupi St 13
▪ <u>Spektori 4:</u> 46- Grupi Q 255, 47 - Grupi Q 104 48 - Grupi Q 321 49 - Grupi Q 204 50 - Grupi Q 218 51- Grupi Q 572 52 - Grupi Q 219	▪ <u>Spektori 3</u> 53- Grupi 181 54- Grupi Fe 4 55 - Grupi Av 52 56 - Grupi Av 1 57 - Grupi 45 58 - Grupi 245	▪ <u>Spektori 5</u> 59 - Grupi Fe 717 60 - Grupi Arza 523 61 - Grupi Fe 64 62 - Grupi Fe 527	

Monitorimi i shkarkimit në ajër:

PM 10,

SO₂ NO_x, VOC, TOC, H₂S, CO.

Shkarkimet në kanalizime:

Rrjedhja m³/h, Rrjedhja ditore m³, rrjedhja max m³/orë, pH, temperatura, toksiciteti, O i shpërbërë, Azot Amonjaku si N mg/l, përbërës organik të fosforit.

Shkarkimet në ujrat sipërfaqësorë:

Rrjedhja m³/h, rrjedhja max m³/orë, grimcat, PM10, pH, temperatura, toksiciteti, O i shpërbërë, Azot Amonjaku si N mg/l, përbërës organik të fosforit, lëndë pezull, BOD₅, produkte naftë, fenole volatile, Sulfide, Metale Toksikë (në total).

Zhurmat:

Matja e nivelit të zhurmës dB (A) (Leq, t).

4. Q.P.N. Gorisht (13 Pika Monitorimi, Leje Tipi A) përfshihen 3 vëndburime Amonicë, Gorisht – Kocul dhe Karbunarë.

- **L. M. me nr. PN-6733-07-2018 dhe me nr identifikues të Lejes 2813 “Nxjerrje e naftës dhe gazit natyror” në vendburimin e naftës Amonicë. (3 pika monitorimi nga nr 63-65).**

- | |
|--|
| <ul style="list-style-type: none">▪ Amonicë63 – Dekantimi64 – Grupi 265 – Grupi 3 |
|--|

Monitorimi i shkarkimit në ajër:

PM 10,

SO₂, NO_x, TOC, H₂S, CO, VOC.

Shkarkimet në kanalizime:

Rrjedhja ditore m³, rrjedhja max m³/orë, pH, temperatura, toksiciteti, O i shpërbërë, Azot Amonjaku si N mg/l, përbërës organik të fosforit.

Shkarkimet në ujrat sipërfaqësorë:

Rrjedhja m³/h, rrjedhja max m³/orë, pH, temperatura, grimcat, PM10, toksiciteti, O i shpërbërë, Azot Amonjaku si N mg/l, përbërës organik të fosforit, lëndët pezull, BOD₅, produkte naftë, fenole volatile, Sulfide, Metale Toksikë (në total).

Zhurmat:

Niveli i zhurmave dB (A) Leq, t.

- **Vendburimi i naftës Gorisht-Kocul, nr. PN-6161-09-2013** “Zhvillimi dhe prodhimi i hidrokarbureve” për vendburimin e naftës (10 pika monitorimi nga nr 66-75).

66 – Dekantimi Gorisht	▪ <u>Sektori 2</u> 69 - Grupi 6 70 - Grupi 17 71 - Grupi 15
▪ <u>Sektori 1</u> 67 - Grupi 2 68 - Grupi 5	▪ <u>Sektori 3</u> 72 - Grupi 9 73 - Grupi 11 74 - Grupi 14
▪ Zona e prodhimit Karbunarë: 75 – Karbunara 14	

Monitorimi i shkarkimit në ajër:

Substancat e ngurta (LN), SO₂, NO₂, CO, H₂S.

Ujrat teknologjike:

pH, lëndë pezull, BOD₅, COD, Nitrat total, Produkte naftë, Cadium, Bakri. Krom 6 valent, Fenole volatile, Benzene, Vinilkloridet, Sulfitet.

Zhurmat:

Niveli i zhurmave dB (A) Leq, t.

5. Q.M.N.Kuçovë (4 Pika monitorimi nga 76-79, Leje Tipi B).

- L. M. me nr. PN-6485-05-2018 dhe me nr identifikues të Lejes 2784.

▪ Funksionimi i Uzinës Mekanike Kuçovë 76 - Reparti i Makinave të Rënda 77 - Reparti Elektrik 78 - Reparti Mekanik 79 - Reparti i Fonderisë
--

Monitorimi i shkarkimit në ajër:

Grimcat,

PM 10,

SO₂, O₂, NO₂, VOC, CO, lëndët e ngurta (LN),

Shkarkimet në kanalizime:

Rrjedha ditore m^3 , rrjedha max $m^3/orë$, pH, temperatura, toksiciteti, O i shpërbërë, Azot Amonjaku si N mg/l, përbërës organik të fosforit, produkte naftë, lëndë pezull, COD, fenole volatile, Cd, As, Cr, Cr (VI), Pb, Hg, Zn, Fe, Ni, Cianid i lirë, Cianid Total.

Shkarkimet në ujrat sipërfaqësorë:

Rrjedha m^3/h , pH, temperatura, toksiciteti, lëndë pezull (TSS),.

Zhurmat:

Niveli i zhurmave dB (A) Leq, t.

Q.SH.GJ.Patos (1 Pikë Monitorimi me nr 80, Leje Tipi B).

- **L. M. me nr. PN-6484-05-2018 dhe me nr identifikues të Lejes 2783.**

80- Funksionimi i Uzinës Mekanike Patos, Fier.

Monitorimi i shkarkimit në ajër:

Grimcat,

PM 10,

SO₂, O₂, NO₂, CO, lëndet e ngurta (LN)

Shkarkimet në kanalizime

Rrjedha $m^3/orë$, rrjedha max $m^3/orë$, pH, temperatura, toksiciteti, O i shpërbërë, Azot Amonjaku si N mg/l, përbërës organik të fosforit, produkte naftë, lëndë pezull, COD, fenole volatile, Cd, Cr, Cr (VI), Pb, Hg, Zn, Cu, Fe, Ni, Cianid i lirë, Cianid Total.

Shkarkimet në ujrat sipërfaqësorë:

Rrjedha m^3/h , pH, temperaturë, toksiciteti, lëndë pezull (TSS).

Zhurmat:

Niveli i zhurmave dB (A) Leq, T.

Periudha e monitorimit do të jetë 12 mujore (çdo tre muaj për pikat e lejeve të tipit A dhe çdo 6 muaj për lejet e tipit B) për të gjitha pika e mësipërme nga data e nënshkrimit të kontratës. Operatori duhet të plotësojë dosjet mjedisore për secilën leje mjedisi sipas kushtit të dokumentimit dhe raportimit dhe 1 kopje të dorëzohet në institucionet përkatëse dhe 1 kopje pranë shoqërisë "Albpetrol" Sh.A.

- **Gjithashtu operatori duhet të studjojë, përpiloj dhe dorëzojë brënda 6 mujorit të parë nga momenti i lidhjes së kontratës për secilën Leje Mjedisori:**

1. Planin e menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme .
2. Programin e Menaxhimit Mjedisor (PMM).
3. Vlerësimin e Riskut Mjedisor.

4. Planin e Përputhshmërisë dhe Afatet Kohore (Kushti 4 në Lejet mjedisore)
5. Programin e Menaxhimit të Riskut Mjedisor.
6. Planin e masave për minimizimin / reduktimin e emetimeve të amoniakut nga burimi i shkarkimit të squfurit.
7. Programin e Monitorimit të Zhurmës.
8. Plani i menaxhimit të emergjencave për shoqërinë “Albpetrol” sh.a.
9. Operatori duhet të përgatisë një model mbi shpërbërjen e ajrit të ndotur referuar pikës 7.1.15 të Lejeve Mjedisore të tipit A.
10. Operatori duhet të përgatisë një plan vlerësimi të ndotjes së ujrave nëntokësor referuar pikës 7.4.3 Lejeve Mjedisore të tipit A.
11. Si pjesë e Raportit Vjetor të Mjedisit, operatori duhet të paraqesë një raport të hollësishëm lidhur me progresin dhe propozimet për reduktimin e ujit të përdorur dhe shkarkimet e ujrave të ndotura.

Po kështu në shtojcën 8 “Formulari i Termave të Referencës”, të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar kërkesat e tij lidhur me shërbimin e kërkuar, si vijon:

Shtojca 8.

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Bazuar në ligjin Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, Neni 41 “Monitorimi i Gjëndjes së Mjedisit”, Neni 44 “Detyrimet e operatorit për monitorimin e përputhshmërisë”, Ligjin 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” i ndryshuar, si dhe në zbatim të kushteve të Lejeve Mjedisore (A dhe B sipas rastit), monitorimi mjedisor është detyrim ligjor dhe duhet të kryhet nga studio ligjore me ekspertë të licensuar dhe me pervojë në fushën e monitorimeve, gjithashtu të kenë paisjet, laboratorët dhe aparatet përkatese, të çertifikuar dhe akredituar. Operatori do të kryejë monitorimin mjedisor sipas specifikimeve teknike, pikave të monitorimit dhe termave të referencës si më poshtë bashkëlidhur.

Periudha e monitorimit do të jetë 12 mujore nga data e nënshkrimit të kontratës.

Referuar ligjit Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, Neni 44 “Detyrimet e operatorit për monitorimin e përputhshmërisë” Pika 3 e këtij neni shprehet: “Operatori mund të kryejë monitorimin nëpërmjet pajisjeve dhe instrumenteve të akredituara që ai disponon ose nëpërmjet laboratorëve të specializuar e të akredituar”, operatori ekonomikë duhet të ketë në pronësi ose me qera, laborator të akredituar për kryerjen e këtyre analizave, (për testimin e gazeve në ajër, zhurmave dhe ujrave të shkarkimit sipas elementëve të kërkuar në secilen prej Leje Mjedisore). Të disponojë Çertifikatë Akreditimi aktive për të gjithë periudhën e shërbimit të kërkuar dhe të këtë ekspertë të licensuar dhe me pervojë në fushën e monitorimeve mjedisore.

Pas nënshkrimit të kontratës, operatori fitues duhet të plotësojë dhe të dorëzojë pranë shoqërisë “Albpetrol” sh.a katër kopje për çdo raport monitorimi mjedisor, si dhe një kopje të dorëzohet pranë AKM Tiranë, në përputhje me kërkesat dhe kushtet e lejeve mjedisore si më poshtë:

Për Lejet Mjedisore të tipit A

6- Monitorimi i shkarkimeve në atmosferë	çdo 3-muaj
7- Monitorimi i shkarkimeve në ujra	çdo 3-muaj
8- Monitorimi i ujrave sipërfaqësorë	çdo 3-muaj
9- Monitorimi i zhurmave dhe vibracioneve	çdo 3-muaj
10- Raporti Vjetor i Mjedisit	1 herë në vit

Për Lejet Mjedisore të Tipit B

7- Monitorimi i shkarkimeve në atmosferë	çdo 6-muaj
8- Monitorimi i shkarkimeve në ujra	çdo 6-muaj
9- Monitorimi i ujrave sipërfaqësorë	çdo 6-muaj
10- Monitorimi i zhurmave dhe vibracioneve	çdo 6-muaj
11- Raporti Vjetor i Mjedisit	1 herë në vit

Në bazë të programit të monitorimit, sipas pikave të përcaktuara kërkohet:

Monitorimi i shkarkimeve në ajër, në kanalizime, shkarkimet në ujrë sipërfaqësorë dhe monitorimi i zhurmave dhe vibracionet, do të kryhet për të gjithë komponentët referuar Kushtit 7 “Shkarkimet”, Kushtit 9 “Zhurmat dhe Vibracionet” dhe Kushtit 11 “Monitorimi” të secilës Leje Mjedisore.

1 - Monitorimi i cilësisë së ajrit

Grimcat, PM₁₀,

Gazet në mjedis SO₂, O₂, NO_x, TOC, H₂S, CO.

2 - Monitorimi i cilësisë së ujrave në kanalizime dhe ujra sipërfaqësorë.

Grimcat, PM₁₀, Rrjedhja, pH, temperaturë, toksiciteti, TSS, NBO-5, NKO, COD, BOD₅ Produkte naftë, Fenole volatile, Sulfide, Klorure, Metale toksik (në total), Azot Amonjak N mg/l, Azot total, Fosfor total, Cd, Cr, Cr (VI), As, Pb, Hg, Zn, Fe, Ni, Cianid i lirë, Cianid Total.

3 - Monitorimi i ndotjes akustike

Zhurma në mjedis dhe në vendin e punës sipas kushteve të përcaktuara në Lejet Mjedisore.

4 – Vibrimet (matja e vibrimeve si pasojë e aktivitetit të operimit)

Matja e vibrimeve do të kryhet për vende të ndjeshme në mm/s (ppv).

Të gjitha monitorimet duhet të kryhen për secilën pikë, në përputhje me Kushtet e Lejeve Mjedisore. Marrja e mostrave dhe analizat duhet të kryhen siç përcaktohen në standartet ISO.

Operatori duhet të disponojë certifikatat e kalibrit që provon se instrumentat që do të përdoren për matjen/testimin e parametrave të lart përmendur përmbushin kushtet teknike dhe janë të kolauduar.

Programi i monitorimit të 7 Lejeve Mjedisore të Albpetrol sh.a. me 80 pika monitorimi është si më poshtë:

6. Q.A.SH.N.G.Patos (12 Pika për Monitorim, Leje Tipi B).

1-Leja Mjedisore (L.M.) PN-6483-05-2018 dhe me nr identifikues të Lejes 2785 (pikat 11-12) dhe 2-LC 4234–PN 3540, dt.21/05/2012 me nr identifikues të Lejes 651 “Shpërndarje dhe magazinim i naftës dhe nënprodukteve në çisterna” (pikat 1-10)

Shënim: 2-LC 4234–PN 3540, dt.21/05/2012 “Shpërndarje dhe magazinim i naftës dhe nënprodukteve në çisterna” për shkak të ndryshimeve ligjore do të rinxirren më vete për çdo stacion. Në momentin e pajisjes me Lejet e reja operatori do kryej monitorimin sipas kushteve të Lejeve të reja.

▪ <u>Stacioni Usoje:</u> <i>1 - Salla e pompave,</i> <i>2 - Parku i rezervuarve,</i> <i>3 - Ne tunele</i>	▪ <u>Stacioni Marinëz-Sheqishte:</u> <i>12- Parku i rezervuarve Marinez</i> ▪ <u>Stacioni Zharrez:</u> <i>7 - Salla e pompave,</i> <i>8 - Parku i rezervuarve 5000 m³,</i> <i>9 - Parku i rezervuarve 700 m³,</i> <i>10 - Kaldaja.</i>
▪ <u>Stacioni Visoke:</u> ▪ <i>4 - Salla e pompave,</i> <i>5 - Parku i rezervuarve,</i>	▪ <u>Stacioni Kuçove:</u> <i>11 - Salla e pompave,</i> <i>12 - Parku i rezervuarve</i>

Në këto pika do të kryhet:

Monitorimi i shkarkimit në ajër:

Grimcat,
PM 10,
VOC, H₂S.

Shkarkimet në kanalizime:

Rrjedhja ditore m³, Rrjedhja m³/h, Rrjedhja max m³/h, pH, temperatura, toksiteti, NBO-5 në 20° pa nitrifikim, NKO, O i shpërbërë, Azot Amonjak N mg/l, përbërës organik të fosforit.

Shkarkimet në ujrat sipërfaqësorë:

Rrjedhja m³/h, pH, temperatura, toksiteti, lëndë pezull (TSS), BOD5, produktet e naftës, fenolet volatile, sulfidet, metalet toksike (në total).

Zhurmat:

Matja e nivelit të zhurmës dB (A) Leq, T.

Vibrimet:

Matja e vibrimeve mm/s (PPV).

7. Q.P.N.Fier (23 Pika Monitorimi, Leje Tipi A) përfshihen 2 vëndburime Patos-Marinez dhe Cakran- Mollaj si më poshtë:

- **L.M. me nr. PN-6621-06-2018 dhe me nr identifikues të Lejes 2807 “Nxjerrja e naftës dhe gazit natyror” për Vendburimi e naftës dhe gazit Patos-Marinëz, Fier (15 pika monitorimi nga 13-27).**

▪ <u>Visokë (Oficina)</u> 13 - Dekantimi Visokë,	21 - St. 8 Patos,
▪ <u>Zharrëz, Sektori 6:</u> 14 - Gr 490 Zharrëz , 15 – Gr – 205, 16 - Gr – 11, 17 – Gr - 9 Kuqar, 18 - Stacioni 6, 19 - Stacioni 4, 20 - Depot pritëse të sektorit 6,	▪ <u>Sektori 5:</u> 22 - Depot pritëse të Sektorit të 5 Oficinë, 23 - Gr-7 Dukas, 24 – Gr – 3 Manekaj, 25 – Gr – 9 Rërëz, 26 - G- 5 – Dukas, 27 - Stacioni 2.

Monitorimi i shkarkimit në ajër:

PM 10,

VOC,

SO₂, NO_x, NO₂, TOC, H₂S, CO.

Shkarkimet në kanalizime:

Rrjedhja ditore m³, Rrjedhja m³/h, rrjedhja max m³/orë, pH, temperatura, toksiciteti, O i shpërbërë, Azot Amonjaku si N mg/l, përbërës organik të fosforit.

Shkarkimet në ujrat sipërfaqësorë:

Rrjedhja ditore m³, Rrjedhja ditore m³/h, rrjedhja max m³/orë, grimcat, PM10, pH, temperatura, toksiciteti, O i shpërbërë, Azot Amonjaku si N mg/l, përbërës organik të fosforit, lëndë pezull, BOD5, produkte naftë, fenole volatile, Sulfide, Metale Toksikë (në total).

Zhurmat:

Matja e nivelit të zhurmës dB (A) (Leq, t).

- **Vendburimi i naftës Cakran - Mollaj L.M. me nr. PN-6161-09-2013 “Zhvillimi dhe prodhimi i hidrokarbureve” për vendburimin e naftës Cakran-Mollaj (8 pika monitorimi nga 28-35).**

<u>Sektori Cakran-Mollaj</u>	30 - Q 25	33 - Q 29
28 - Dekantimi Usojë	31 - Q 59	34 - Q 38
29 - Grupi 3 Mollaj	32 - Q 17	35 - Q 35

Monitorimi i shkarkimit në ajër:

Substancat e ngurta (LN), SO₂, NO₂, H₂S.

Ujrat teknologjike:

pH, lëndë pezull, BOD₅, COD, Nitrat total, Produkte naftë, Cadum, Bakri. Krom 6 valent, Fenole volatile, Benzene, Vinilkloridet, Sulfitet.

Zhurmat:

Niveli i zhurmave dB (A) Leq, T.

8. Q.P.N.Kuçovë (27 Pika Monitorimi, Leje Tipi A)

- **L.M. PN-6622-06-2018 dhe me nr. identifikues të Lejes 2806 “Nxjerrje e naftës dhe gazit natyror” në vendburimi e naftës Kuçovë (27 Pika Monitorimi nga nr 36-62).**

▪ <u>Sektori 6 :</u> 36 - Dekantimi dhe Stacioni Qendror, 37 - Stacioni i Lumit.	▪ <u>Sektori 2:</u> 38 - Grupi St-5 39 - Grupi Q- 163 40 - Grupi 522 41 - Grupi Q 200 42 - Grupi St 82 ▪ <u>Sektori 1</u> 43 - Grupi Ç - 1 44 - Grupi 223 45 - Grupi St 13
▪ <u>Sektori 4:</u> 46- Grupi Q 255, 47 - Grupi Q 104 48 - Grupi Q 321 49 - Grupi Q 204 50 - Grupi Q 218 51- Grupi Q 572 52 - Grupi Q 219 ▪ <u>Sektori 3</u> 53- Grupi 181 54- Grupi Fe 4 55 - Grupi Av 52 56 - Grupi Av 1 57 - Gupi 45 58 - Grupi 245	▪ <u>Sektori 5</u> 59 - Grupi Fe 717 60 - Grupi Arza 523 61 - Grupi Fe 64 62 - Grupi Fe 527

Monitorimi i shkarkimit në ajër:

PM 10,
SO₂ NO_x, VOC, TOC, H₂S, CO.

Shkarkimet në kanalizime|:

Rrjedhja m³/h, Rrjedhja ditore m³, rrjedhja max m³/orë, pH, temperatura, toksiciteti, O i shpërbërë, Azot Amonjaku si N mg/l, përbërës organik të fosforit.

Shkarkimet në ujrat sipërfaqësorë:

Rrjedhja m³/h, rrjedhja max m³/orë, grimcat, PM10, pH, temperatura, toksiciteti, O i shpërbërë, Azot Amonjaku si N mg/l, përbërës organik të fosforit, lëndë pezull, BOD₅, produkte naftë, fenole volatile, Sulfide, Metale Toksikë (në total).

Zhurmat:

Matja e nivelit të zhurmës dB (A) (Leq, t).

9. Q.P.N. Gorisht (13 Pika Monitorimi, Leje Tipi A) përfshihen 3 vëndburime Amonicë, Gorisht – Kocul dhe Karbunarë.

- **L. M. me nr. PN-6733-07-2018 dhe me nr identifikues të Lejes 2813** “Nxjerrje e naftës dhe gazit natyror” në vendburimin e naftës Amonicë. (3 pika monitorimi nga nr 63-65).

▪ Amonicë
63 – Dekantimi
65 – Grupi 2
65 – Grupi 3

Monitorimi i shkarkimit në ajër:

PM 10,

SO₂, NO_x, TOC, H₂S, CO, VOC.

Shkarkimet në kanalizime:

Rrjedhja ditore m³, rrjedhja max m³/orë, pH, temperatura, toksiciteti, O i shpërbërë, Azot Amonjaku si N mg/l, përbërës organik të fosforit.

Shkarkimet në ujrat sipërfaqësorë:

Rrjedhja m³/h, rrjedhja max m³/orë, pH, temperatura, grimcat, PM10, toksiciteti, O i shpërbërë, Azot Amonjaku si N mg/l, përbërës organik të fosforit, lëndët pezull, BOD₅, produkte naftë, fenole volatile, Sulfide, Metale Toksikë (në total).

Zhurmat:

Niveli i zhurmave dB (A) Leq, t.

- **Vendburimi i naftës Gorisht-Kocul, nr. PN-6161-09-2013** “Zhvillimi dhe prodhimi i hidrokarbureve” për vendburimin e naftës (10 pika monitorimi nga nr 66-75).

66 – Dekantimi Gorisht	▪ <u>Sektori 2</u> 69 - Grupi 6
------------------------	---

	70 - Grupi 17 71 - Grupi 15
▪ <u>Sektori 1</u> 67 - Grupi 2 68 - Grupi 5	▪ <u>Sektori 3</u> 72 - Grupi 9 76 - Grupi 11 77 - Grupi 14
▪ Zona e prodhimit Karbunarë: 78 – Karbunara 14	

Monitorimi i shkarkimit në ajër:

Substancat e ngurta (LN), SO₂, NO₂, CO, H₂S.

Ujrat teknologjike:

pH, lëndë pezull, BOD₅, COD, Nitrat total, Produkte naftë, Cadium, Bakri. Krom 6 valent, Fenole volatile, Benzene, Vinilkloridet, Sulfitet.

Zhurmat:

Niveli i zhurmave dB (A) Leq, t.

10. Q.M.N.Kuçovë (4 Pika monitorimi nga 76-79, Leje Tipi B).

- **L. M. me nr. PN-6485-05-2018 dhe me nr identifikues të Lejes 2784.**

▪ Funksionimi i Uzinës Mekanike Kuçovë 76 - Reparti i Makinave të Rënda 77 - Reparti Elektrik 78 - Reparti Mekanik 79 - Reparti i Fonderisë

Monitorimi i shkarkimit në ajër:

Grimcat,

PM 10,

SO₂, O₂, NO₂, VOC, CO, lëndët e ngurta (LN),

Shkarkimet në kanalizime:

Rrjedha ditore m³, rrjedha max m³/orë, pH, temperatura, toksiciteti, O i shpërbërë, Azot Amonjaku si N mg/l, përbërës organik të fosforit, produkte naftë, lëndë pezull, COD, fenole volatile, Cd, As, Cr, Cr (VI), Pb, Hg, Zn, Fe, Ni, Cianid i lirë, Cianid Total.

Shkarkimet në ujrat sipërfaqësorë:

Rrjedha m³/h, pH, temperatura, toksiciteti, lëndë pezull (TSS),.

Zhurmat:

Niveli i zhurmave dB (A) Leq, t.

Q.SH.GJ.Patos (1 Pikë Monitorimi me nr 80, Leje Tipi B).

- L. M. me nr. PN-6484-05-2018 dhe me nr identifikues të Lejes 2783.

80- Funksionimi i Uzinës Mekanike Patos, Fier.

Monitorimi i shkarkimit në ajër:

Grimcat,

PM 10,

SO₂, O₂, NO₂, CO, lëndet e ngurta (LN)

Shkarkimet në kanalizime

Rrjedha m³/orë, rrjedha max m³/orë, pH, temperatura, toksiciteti, O i shpërbërë, Azot Amonjaku si N mg/l, përbërës organik të fosforit, produkte nafte, lëndë pezull, COD, fenole volatile, Cd, Cr, Cr (VI), Pb, Hg, Zn, Cu, Fe, Ni, Cianid i lirë, Cianid Total.

Shkarkimet në ujrat sipërfaqësorë:

Rrjedha m³/h, pH, temperaturë, toksiciteti, lëndë pezull (TSS).

Zhurmat:

Niveli i zhurmave dB (A) Leq, T.

Periudha e monitorimit do të jetë 12 mujore (çdo tre muaj për pikat e lejeve të tipit A dhe çdo 6 muaj për lejet e tipit B) për të gjitha pika e mësipërme nga data e nënshkrimit të kontratës. Operatori duhet të plotësojë dosjet mjedisore për secilën leje mjedisi sipas kushtit të dokumentimit dhe raportimit dhe 1 kopje të dorëzohet në institucionet përkatëse dhe 1 kopje pranë shoqërisë "Albpetrol" Sh.A.

- **Gjithashtu operatori duhet të studjojë, përpiloj dhe dorëzojë brënda 6 mujorit të parë nga momenti i lidhjes së kontratës për secilën Leje Mjedisore:**

12. Planin e menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme .

13. Programin e Menaxhimit Mjedisor (PMM).

14. Vlerësimin e Riskut Mjedisor.

15. Planin e Përputhshmërisë dhe Afatet Kohore (Kushti 4 në Lejet mjedisore)

16. Programin e Menaxhimit të Riskut Mjedisor.

17. Planin e masave për minimizimin / reduktimin e emetimeve të amoniakut nga burimi i shkarkimit të squfurit.

18. Programin e Monitorimit të Zhurmës.

19. Plani i menaxhimit të emergjencave për shoqërinë "Albpetrol" sh.a.

20. Operatori duhet të përgatisë një model mbi shpërbërjen e ajrit të ndotur referuar pikës 7.1.15 të Lejeve Mjedisore të tipit A.
21. Operatori duhet të përgatisë një plan vlerësimi të ndotjes së ujrave nëntokësor referuar pikës 7.4.3 Lejeve Mjedisore të tipit A.
22. Si pjesë e Raportit Vjetor të Mjedisit, operatori duhet të paraqesë një raport të hollësishëm lidhur me progresin dhe propozimet për reduktimin e ujit të përdorur dhe shkarkimet e ujrave të ndotura.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktorë garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktorë nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktorë janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020, “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor

Në nenin 77 "Kërkesat për kualifikim", të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", pika 1 dhe 4, parashikohet shprehimisht se: "1. Autoritetet ose entet kontraktorë përcaktojnë kërkesat

për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktorë mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cënuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme, edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të, cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.1.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushjen me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre,

ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.7. Lidhur me pretendimet e ankimuesit, KSHA ka arsyetuar si vijon: “KSHA nga shqyrtimi i dosjes së tenderit, komunikimi me KVO dhe keqyrja e dokumentacionit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi në SPE, konstaton se:

Për sa i përket pretendimit Tuaj mbi mospërmbushjen e kriterit 2.3.8 të DST-së, nga ana e OE pjesëmarrës “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analyses & Testing” SHPK, Ju sqarojmë se OE në shtojcën 10 Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit deklaron se “disponon Laborator i Akredituar ne pronesi per te gjitha parametrat e kerkuar ne termat e references. Certifikata bashkangjitur”. Ky kriter nga ana e KVO kondiderohet i plotësuar dhe duhet të konsiderohet si i tillë pasi kërkesa e AK në DST është konkretisht: “Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet te paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.10. Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzoje pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër”. Pra detyrimi i OE për këtë fazë përzgjedhjeje ka qënë deklarimi nëpërmjet shtojcës 10.

Nisur nga fakti që për shkak të ofertës më të ulët në këtë konkurim ky OE është shpallur fitues, ai ka paraqitur dokumentacionin justifikues pranë AK.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE si rezultat i shpalljes së tij fitues, në dosjen e tenderit, konstatohet se OE ka paraqitur dokumentacionin plotësues për kriterin 2.3.8. pra dokumentacionin me të cilin vërteton disponimin e laboratorit të akredituar sipas kërkesave të AK në specifikimet teknike. OE ka paraqitur pranë AK dokumentacionin (certifikatë akreditimi) për Laboratorin në pronësi të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit sipas ISO 17025:2017, per monitorimin e cilesise se ajrit, ujit dhe monitorimin e zhurmave, sipas termave te references, akredituar më 11.03.2024 të vlefshme deri më datë 10.03.2028.”.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi ofertën e paraqitur në SPE nga operatori ekonomik “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analyses & Testing” SHPK, ku rezulton se është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

- Shtojca 10 “Formulari i përmbledhës i vetëdeklarimit”, ku në Pjesën III “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika “B” DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”, për disponimin e laboratorit të

kërkuar, nga ana e operatori ekonomik “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analyses & Testing” SHPK është deklaruar si vijon:

	<u>Makineri e mjete</u> Po [X] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: Sipas listes bashkëngjitur Pajisje laborator Ne pronesi Automjet AA718RH Ne pronesi Leje Qarkullimi, Siguracion, Taksa, Vertetim Pronesie, Akt Kolaudim Laborator i Akredituar ne pronesi per te gjitha parametrat e kerkuar ne termat e references. Certifikata bashkëngjitur
--	--

- Certifikatë akreditimi, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për “ECCAT” SHPK në datën 11.03.2024, e vlefshme deri më 10.03.2028. Sipas kësaj certifikate, “ECCAT” SHPK , Laborator Testues, është akredituar për kryerjen e testeve në përputhje me S SH ISO/IEC 17025:2017 “Kërkesa të përgjithshme për kompetencën e laboratorëve testues dhe kalibruës” dhe bashkëngjitu rështë lista e testeve për të cilat është i vlefshëm akreditimi.

III.1.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të

vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon se, autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

Duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, KPP konstaton se, pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues konsistojnë në faktin se operatori ekonomik “ECCAT” SHPK nuk i ploteson të gjitha parametrat e kërkuara në shtojcën nr.8 “*Formulari i termave të referencës*” dhe konkretisht, sipas ankimuesit, në certifikatën e akreditimit të operatorit ekonomik ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analyses & Testing mungojnë parametrat e ujit: temperature, toksiciteti, rrjedha, rrjedha ditore, rrjedha maksimale, grimcat dhe PM10.

Nisur nga ankesa e paraqitur, Komisioni i Prokurimit Publik bëri verifikime në web-in e DPA-së <http://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/> nga ku rezultoi se “ECCAT” SHPK është akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit dhe është pajisur me Certifikatë akreditimi LT 128, datë 11.03.2024, lëshuar për “ECCAT” SHPK, e vlefshme deri më 10.03.2028. Sipas kësaj certifikate, “ECCAT” SHPK, Laborator Testues, është akredituar për kryerjen e testeve në përputhje me S SH ISO/IEC 17025:2017 “*Kërkesa të përgjithshme për kompetencën e laboratorëve testues dhe kalibrues*” dhe bashkëngjitur saj është lista e testeve për të cilat është i vlefshëm akreditimi.

Gjithashtu, në kuadër të shqyrtimit administrativ të ankesës në mënyrë sa më transparente dhe të drejtë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykoi të nevojshëm se, për sqarimin e fakteve, kërkohen verifikime të posacme pranë organeve kompetente si Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit si institucioni i vetëm publik, i cili në bazë të ligjit nr 116 datë 11.09.2014 “*Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë*”, në nenin 4 të tij ka përcaktuar se “*Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit është i vetmi organizëm kombëtar që kryen akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit*”. Për këtë qëllim nëpërmjet shkresës me nr. 3735/12 prot., datë 17.01.2025 Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit shprehimisht si vijon: “Në

kuadër të shqyrtimit të ankesës së paraqitur për një procedurë prokurimi, Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e kryerjes së procedurës së hetimit administrativ, lidhur me pretendimet e ngritura. Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës konstatohen pretendime lidhur me përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor përsa i përket specifikimeve teknike dhe konkretisht pretendohet se: “ne certifikaten e akreditimit të operatorit ekonomik ECCAT Environmental consulting, chemical analyses & testing mungojnë parametrat e ujit si më poshtë:

? temperature

? toksiciteti

? rrjedha,

? rrjedha ditore,

? rrjedha maksimale,

? grimcat,

? PM10.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 115, pika 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” si dhe ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, KPP ju drejtohet juve, si institucion kompetent, për një sqarim nëse Certifikata e Akreditimit, me Nr. Regjistrimi LT 128, “Laborator Testues” lëshuar nga ana juaj për shoqërinë “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analyses & Testing” SHPK, lejon apo jo kryerjen e testimeve për parametart e ujit si më sipër cituar.”

Në vijim të korrespondencës së sipërcituar, në datën 03.02.2025 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 3735/13 prot., shkresa e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit nr. 75/1 prot., datë 22.01.2025 me objekt: “Kthim përgjigje”, nëpërmjet të cilës Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) bën me dije KPP-në se në faqen zyrtare të DPA, <https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara>, janë pasqyruar të gjithë laboratorët e akredituar si dhe fusha përkatëse e akreditimit ku mund të merret informacion i detajuar për analizat e kërkuara. Gjithashtu DPA sqaron se treguesi “PM10” është një parametër i cilësisë së ajrit, (nuk matet PM10 në ujë), ndërsa treguesi “Grimcat” përfaqësojnë substanca të pezulluara në ujë (p.sh sedimentet). Në ujë matet lënda pezull dhe TSS. (Testi nr.21 në listën e testeve të akredituara të laboratorit ECCAT- Environmental Consulting, Chemical Analyses&Testing” SHPK). Për më tepër DPA sqaron se Laboratori ECCAT nuk është i akredituar për parametrat e ujit si: Temperatura, rrjedha, rrjedha ditore dhe rrjedha maksimale si dhe Laboratori ECCAT nuk është i akredituar për matjen direkt të parametrave të toksicitetit në ujë, por është i akredituar për matjen e Hidrokarbureve Policiklike Aromatike (PAH) , alifatike, bifenilet e polikloruara (PCB) si dhe për matjen e metaleve të rënda. (Testet nr. 58, 59, 60, 62, 71, 72, 75, 77, 79, 118 në listën e testeve të akredituara të laboratorit ECCAT- Environmental Consulting, Chemical Analyses&Testing” SHPK).

Pra, referuar termave të referencës të parashikuara nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit si më sipër cituar, përsa i përket treguesve teknike të monitorimit të cilësisë së ujrave në kanalizime dhe ujrave sipërfaqësorë, operatori ekonomik “ECCAT- Environmental Consulting, Chemical Analyses&Testing” SHPK).” sh.p.k, nuk është i akredituar për kryerjen e analizave të ujit për të gjithë elementët e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në

shtojcën 8 “*Formulari i Termave të Referencës*”, pasi operatori ekonomik objekt ankimimi nuk është i akredituar për parametrat e ujit: Temperatura, rrjedha, rrjedha ditore dhe rrjedha maksimale si dhe nuk është i akredituar për matjen direkt të parametrit të toksicitetit në ujë. Komisioni gjykon se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomik kryejnë aktivitetin objekt prokurimi të akredituar për të gjithë elementët e përcaktuar në termat e referencës. Në rastin konkret, Komisioni gjykon se operatori ekonomik “ECCAT-Environmental Consulting, Chemical Analyses&Testing” SHPK, nuk garanton autoritetin kontraktor se shërbimet tij (analizat) do të kryhen sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, pasi i mungon akreditimi për analizimin për një pjesë të madhe të elementëve, e për pasojë ndodhemi në kushtet e mospërbushjes të kriterit të vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.8, të shtojcës 9, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Komisioni thekson se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për sa i përket operatorit ekonomik “Environmental management consultants” SHPK Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*), nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi të cilët kanë ofertuar me një vlerë më të lartë ekonomike, ndaj dhe këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim nga ky Komision.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-29950-11-19-2024 me objekt “*Shërbim për monitorim mjedisi*” me fond limit 11,894,396 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol SHA.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin për kualifikimin e operatorit ekonomik “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analyses & Testing” SHPK, duke e skualifikuar atë.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

